

POP
PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

KONTRATA
SOCIALE



KORÇË

POP
PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE



KONTRATA SOCIALE



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane
 +355 4 22 555 14
 +355 69 61 20 169
 perballjaofertavepolitike@gmail.com
 www.popnetwork.al
 POPNetworkAlbania
 POPAlbania2020
 pop_perballjaofertavepolitike

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP, është nismë e një rrjeti organizatash të shoqërisë civile shqiptare. POP synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për deputetë dhe për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre. POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015, Zgjedhjeve Parlamentare 2017, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2019 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2021. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe National Endowment for Democracy. POP 2021 organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë, Elbasan dhe Vau i Dejës, aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP synon:

Nxitjen e dialogut mes zgjedhësve dhe kandidatëve për zgjedhjet lokale dhe ato parlamentare, por edhe ndërmjet vetë kandidatëve, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre, si dhe fuqizimin e OSHC-ve të ndryshme për të monitoruar dhe advokuar pranë bashkive për zbatimin e kornizës ligjore dhe përbushjen e prioritetëve të kontratës sociale.

Objektivat specifike POP-2021:

- Forcimi i rrjetit POP duke u zgjeruar me organizata të reja që mbulojnë bashki të tjera.
- Forcimi i marrëdhënieve midis qytetarëve, POP dhe aktorëve të tjerë në shoqëri.
- Monitorimi, raportimi dhe veshja me përgjegjësi e drejtuesve në nivelin lokal për të përbushur kontratën sociale në secilën bashki.
- Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP do të punojë për të arritur rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjeshtë një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e bashkive.

POP vazhdon të monitorojë Kontratën Sociale realizuar gjatë vitit 2019, dhe gjatë vitit 2021 vjen me realizimin e Kontratave Sociale për 3 bashki të tjera, Korçë, Elbasan dhe Vau i Dejës, si rezultat i zgjerimit të tij me 3 organizata të reja që operojnë në këto bashki.

Në lidhje me Zgjedhjet Parlamentare 2021, rrjeti POP ka informuar dhe vazhdon të informojë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse, premtime të bëra prej tyre në prag të këtyre zgjedhjeve, si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, ju ofron qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Kjo kontribuon për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet e organizuara në kuadër të POP, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njërit-tjetrin, si dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike. Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre.

Gjatë periudhës parazgjedhore për vitin 2021, zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike ishte shumë e rëndësishme. POP ju dha një mundësi partive politike që të paraqisnin programet e tyre dhe të tregonin se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të vazhdojnë të monitorohen pas Zgjedhjeve parlamentare 2021 nga Rrjeti i organizatave të POP dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.


ORGANIZATAT E RRJETIT POP

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim', Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Qendra Rinore Vlorë
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz
- Epoka e Re, Fier
- Intelktualët e Rinj Shpresë, Shkodër
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra Rinore për Progres, Kukës
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec
- Shoqata Tjetër Vizion, Elbasan
- Shoqata Gruaja në Zhvillim Korçë, Korçë
- Qendra Sociale Hapa të Lehtë, Vau i Dejës.

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

Banorët e Bashkisë Korçë u përfshinë në 5 forume, të zhvilluara gjatë muajit maj 2021, me qëllim identifikimin e prioritetëve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej 5 forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunësuar, me nivele të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Pjesëmarrja sipas gjinive



Në secilin prej forumeve të zhvilluara, qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 26 çështje, që përfshihen në katër fusha kryesore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensionimi social




Demokracia vendore

Për secilën prej 26 çështjeve objekt diskutimi, qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi çështjet që përbëjnë prioritet për ta, e për rrjedhojë, duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendorë.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve, prioritetet e komunitetit u organizuan në tre grupe:

1. **Ndërrhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërrhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;
3. **Vijueshmëri**, përfshin çështje të cilat kanë arritur zhvillimin e pritshëm nga komuniteti dhe për to nevojitet vetëm ruajtje e të njëjtit standard nga të zgjedhurit vendorë.



23 janë prioritet e komunitetit të prezantuar gjerësisht në vijim, sipas shkallës së rëndësisë që i kanë dhënë vetë qytetarët, për të cilat do të llobohet dhe do të advokohet për t'u reflektuar për zgjidhje gjatë hartimit të projektbuxheteve për vitet në vazhdim 2022, 2023 dhe për të qenë pjesë e axhendës së kandidatëve për kryetarë bashkie përgjatë procesit parazgjedhor për Zgjedhjet Lokale të vitit

PRIORITETET E KOMUNITETIT

Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE

Janë **6 çështjet** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE • Infrastruktura, rrugë dhe trotuare; • Shkollat	DIMENSIONI SOCIAL • Shërbime të kujdesit shoqëror për individët në nevojë; • Problematika të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR • Nxitja e punësimit	DEMOKRACIA VENDORE - MIRËQEVERISJA • Pjesëmarrja në vendimarrje

Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE

Janë **10 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë disi prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE • Pastrimi • Furnizimi me ujë dhe kanalizimet • Kanalet kulluese/vaditëse • Kopshtet dhe çerdhet • Transporti publik	ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR • Shërbimi veterinar • Niveli i taksave/tarifave në raport me shërbimin • Planifikimi strategjik	DIMENSIONI SOCIAL • Programe dhe shërbime të bashkisë mbi adresimin e dhunës në familje
--	--	---

Grupi i tretë / NDËRHYRJE VIJUESE

Janë **7 çështje** që kanë marrë vlerësimin më të lartë nga pjesëmarrësit në Forume.

SHËRBIMET PUBLIKE • Pyjet dhe kullotat	DEMOKRACIA VENDORE • Informimi dhe komunikimi • Transparenca në vendimarrje
ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR • Planifikimi strategjik • Takime publike për buxhetin • Njoftimi i qytetarëve mbi detyrimin për taksat/tarifat	DIMENSIONI SOCIAL • Pjesëmarrja e grave në vendimarrje

Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE

Janë **6 çështjet** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

SHËRBIMET PUBLIKE

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

Në të gjitha forumet u nënvizua situata e mirë në rrugët kryesore, por u vlerësua shumë prioritare riparimi i të gjitha rrugëve dytësore dhe brendësitë e lagjeve. Prioritetet e listuara i përkasin ndërhyrjes në rrugët dytësore, si dhe përmirësime të ndryshme infrastrukture. Ndriçimi është i mirë, por ngelet akoma prioritet të ndërhyhet në disa zona të caktuara.

Prioritet 1. Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për secilën njësi.

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)
 Vendosja e sinjalistikave, tek "Trekëndëshi" dhe "Dritat e Verdha", pasi shpesh në këto vende kanë ndodhur aksidente. Lagjja 15, ka nevojë për semafor, pasi po bëhet burim aksidentesh.

Rajoni 1, kërkohën riparimin e trotuareve tek Rr. "Theodor Kavaljoti". Tek Lagjja 10 (Blloku i Francezëve), ku jetojnë 29 familje të komunitetit rom, kërkohet përmirësimi i ndriçimit dhe pastrimit.

Rajoni 2, kërkohet asfaltimi i rrugëve "Mihal Ciko", "Naum Karanxha", "Koli Çeku" (Lagjja 4). ndërtimi i trotuareve në rrugët "Naum Karanxha", "Koli Çeku" dhe "Aleksandra Ilo" (Lagjja 4).

Rajoni 3, kërkohet asfaltimi i rrugëve "Thanas Rëmaçka" (Lagjja 6) dhe i rrugëve dytësore tek "Ruga e Leshpunueses" (Lagjja 18).

Njësia administrative Qendër Bulgarec
 Fshati Bulgarec. Kërkohet ndërhyrje për asfaltimin e rrugëve që lidhin fshatin me zonat jashtë njësisë administrative. Konkretisht, Rruga Bulgarec-Çiflig është e paasfaltuar, ndërsa rruga Bulgarec-Shamoll ka vetëm një shtresë të shtruar me çakull.

Pajisjen e rrugëve kryesore të fshatit me trotuare dhe specifikisht Rruga e të Krishterëve.

Pajisjen me ndriçim të të gjitha rrugëve të fshatit Bulgarec, ndërkohë që ka mungesë ndriçimi në 20% të rrugëve të fshatit, atje ku ka shtëpi të veçuara.

Pajisjen me ndriçim të Rrugës Nacionale, që përfshin zonën prej "Urës së Dunavecit" deri tek "Delta".

Njësia administrative Drenovë
 Fshati Mborje. Kërkohet asfaltimi i rrugës nga shkolla deri në qendër dhe rrugës "Pavlo Sholla". Sistemimi i kanaleve të ujrave të zeza në rrugën e Koresë, Ulicës dhe Kasabasë dhe paisja edhe e rrugëve jokryesore me ndriçim.

Njësia administrative Mollaj
 Fshatin Mollaj. Kërkohet asfaltimi i rrugës së Sallatashit, përfundimi i rrugëve "Haxhi Sherifi" dhe "Xhamia". Gjithashtu, shtrimi i rrugëve drejt parcelave bujqësore.

SHKOLLAT

Prioritet 2. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)
 Rikonstruksioni i gjimnazit "Themistokli Gërmenji": ndërrimi i dritareve (të cilat janë shumë të amortizuara dhe ulin efikasitetin e ngrohjes gjatë muajve të dimrit) si dhe ndërrimi i kaldajës, e cila është shumë e amortizuar.

Rikonstruksioni i dritareve dhe tualeteve në gjimnazin "Isuf Gjata" (Gjimnazi 3), brenda ambienteve të së cilit ka shumë lagështi. si dhe ndërtimi i një palestere për këtë shkollë.

Po ashtu, kërkohet rikonstruksioni i shkollës "Ismail Qemali" si dhe ndërhyrja në ambientet e brendshme dhe në këndin sportiv të shkollës nëntëvjeçare "Asdreni".

Njësia administrative Qendër Bulgarec
 Kërkohet shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Bulgarec, duke qenë se përdoren nga tre grupmosha të ndryshme dhe janë të pamjaftueshme. Po ashtu, kërkohet edhe ndërtimi i një palestere dhe një ambienti për argëtim dhe lojra jashtë orarit shkollor, duke shfrytëzuar një mjedis të lirë pranë shkollës.

Njësia administrative Drenovë
 Kërkohet ndërtimi i një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje, në ambientin prapa shkollës.

Njësia administrative Mollaj
 Kërkohet shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Mollaj, të cilat janë të pamjaftueshme pasi përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. Po ashtu, dhe izolimi i lagështisë dhe amortizimit në këtë shkollë.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

NXITJA E PUNËSIMIT

Një ndër problemet e shumta me të cilat ndeshen të rinjtë është papunësia.

Duke iu referuar statistikave të marra nga DRAPKA Korçë, deri në prill 2021, rezultojnë gjithsej 2997 punëkërkuar, prej të cilëve 24.22% janë të rinj deri në moshën 29 vjeç dhe shumë prej tyre nuk regjistrohen. Korça ofron mundësi punësimi dhe përfshirje, kryesisht në sektorin e turizmit dhe agrobiznesit.

Fondi i rinisë është limituar dhe cinguar, sepse numri i intershipëve është shumë i kufizuar në raport me numrin total të studentëve të cilët diplomohen nga universiteti "Fan Stilian Noli".

Prioritet 3. Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet iniciativave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.

DIMENSIONI SOCIAL NË NIVEL VENDOR

SHËRBIME TË KUJDESIT SHOQËROR PËR INDIVIDËT NË NEVOJË

Në tërësi, të gjitha grupet ishin disi të informuara mbi punën e Bashkisë për të mbështetur individët në nevojë për shërbime.

Prioriteti 4. Rritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Në Mborje, kërkohet të ndihmohen me strehim familjet në nevojë dhe sidomos ato me fëmijë me nevoja të veçanta.

Në Korçë, kërkohet të ketë më shumë shërbime për gratë me fëmijë me aftësi të kufizuara, si dhe për këto familje, të paktën njëri nga prindërit të jetë i siguruar ose i punësuar.

Gjithashtu, kërkohet edhe përmirësimi i kushteve tek Qendra e të Moshuarve.

KOMUNITETI I ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE

Problemet më të shumta në lidhje me komunitetin rom dhe egjiptian u evidentuan në qytetin e Korçës. Ndërsa në zonat e ish-komunave ose nuk ekzistojnë këto komunitete, ose pjesëmarrësit u shprehën se ata gëzojnë të drejta të barabarta me të gjithë banorët.

Ndërkohë që problematikat social-ekonomike për këto komunitete në qytetin e Korçës janë të shumta, disa prej të cilave si më poshtë:

Strehimi:

Zona e ish-Gjeologjikes, konvikti i Shkollës Bujqësore, konvikti tek shkolla "Demokracia". Në këto 3 zona, jetojnë afërsisht 150 familje në kushte shumë të vështira, ku ka mungesë të ujit, lagështirë, tualete të përbashkëta, si rrjedhim dhe higjienë në nivele shumë të ulta.

Kjo kategori nuk mund të përfitojë nga programet e Strehimit Social, sepse nuk i përmbush kriteteret, për shkak të të ardhurave mujore shumë të ulta.

Për momentin kërkohet nga qytetarët dezinfektimi i ambjentëve, sigurimi i ujit të pijshëm dhe restaurimi i ambienteve ku ata banojnë.

Arsimi:

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve dhe në Planin Lokal të Bashkisë, përcaktohet pagesa falas e tarifës së kopshteve me drekë. Kjo do të thotë që, bashkia paguan regjistrimin dhe ushqimin e fëmijëve që vijnë nga këto komunitete. Bashkia Korçë ka vënë kusht që, kjo tarifë t'u paguhet vetëm atyre fëmijëve, prindi i të cilëve punon ose ndjek një kurs profesional.

Gjithashtu, është shumë i vështirë regjistrimi i këtyre fëmijëve edhe në kopshtet pa drekë, pa pagesë, për shkak se numri i kërkesës është shumë i lartë krahasuar me kapacitetin që ofrojnë këto kopshte.

Qytetarët u shprehën se, kjo ndikon negativisht tek kjo kategori për integrimin e këtyre fëmijëve në shoqëri që në moshë të vogël duke penalizuar kështu fëmijët. Ndërsa u kërkua nga qytetarët që t'u jepet mundësi këtyre grupeve të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht gjendjes së prindërve.

Prioritet 5. Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimit dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit rom dhe egjiptian.

DEMOKRACIA VENDORE – MIRËQEVERISJA

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

Nga diskutimet me pjesëmarrësit doli në pah se, takimet në kuadër të buxhetimit me pjesëmarrje të jenë më efektive dhe të përdoren edhe forma të tjera konsultimi duke rritur numrin e këtyre konsultimeve.


Njoftimet për takimet publike në zonat rurale bëhen nga kryeplaku i fshatit, i cili njofton banorët nëpërmjet takimeve derë më derë, ose nëpërmjet telefonatave dhe në këto takime marrin pjesë më tepër burrat. Sipas banorëve mendimi edhe shprehet, por sa meritë parasysh kjo nuk dihet. Gjithsesi, ka një tendencë për të mos shprehur problemet publikisht, por duke përfutur nga këto takime të kontaktohet kryetari personalisht duke e trajtuar problemin si personal. Ka edhe zona si për shembull Mollaj, ku banorët u shprehën që kryeplaku nuk është funksional dhe ata nuk marrin informacion për takimet publike.

Një problem tjetër i vënë në dukje ishte edhe mungesa e dëgjësive publike së fundmi, kjo dhe për shkak të pandemisë dhe shpallja e njoftimeve jo në afatin kohor

të duhur. Shumica e pjesëmarrësve në forumet, nuk kishin qenë pjesë në asnjë mbledhje të Këshilli Bashkiak, por edhe ata të cilët kishin marrë pjesë shprehën shqetësimin se mbledhjet e këshillit janë bërë me numër të reduktuar qytetarësh dhe nuk u jepet e drejta e fjalës.

Prioritet 6. Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.

- të përdorë edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin;
- të mundësojë përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;
- të raportojë sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimmarrjet e saj.



SHËRBIMET PUBLIKE

PASTRIMI

Nga diskutimet u vu në dukje se çështja e pastrimit në vija të përgjithshme është zgjidhur, por ka akoma zona problematike. Duhet kushtuar vëmendje për zona të caktuara.

Prioriteti 7. Përmirësim i cilësisë së pastrimit në disa zona si më poshtë.

Mborje: Pastrimi i mbetjeve urbane në lumë. Grumbullimi nga Bashkia i mbetjeve të tilla si shkarpa, mbetje kopshtarie, etj. Pastrimi i kanaleve anës rrugëve. Pastrimi i zonës piktoreske të quajtur "Çezma e Kodhelit" nga mbeturinat. Pastrimi i varrezave. Vendosja e një punonjësi nga bashkia që të kujdeset për mirëmbajtjen e varreve.

Mollaj: Shtimi i numrit të koshave. Mbledhja e plehrave në një orar të caktuar.

Korçë: Shtimi i numrit të koshave Lagjja 6, Rr. "Thanas Rëmaçka". T'i kushtohet vëmendje pastrimit tek Lgj. 10, Rr. "Theodhor Kavaljoti" e cila ka mjedise të papastuara nga mbeturinat.

FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET

Përfaqësuesit e komunitetit në të gjitha njësitet theksuan se Bashkia ka punuar për të zgjidhur problemet me ujë dhe pijshëm dhe kanalizimet por ka disa zona ku ngelet prioritet bazuar në vlerësimin e qytetarëve.

Prioritet 8. Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë, cilësinë dhe sistemimi i kanaleve në disa fshatra.

Mollaj: Vendosja e filtrave për të shmangur turbullimin e ujit të pijshëm kur bie shi.

Mborje: Furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm në periudhën e verës, pasi depoja e ujit është e vogël. Kërkohet nga banorët, të furnizohen me ujë dhe zonës së tyre duke zgjeruar depozitat ujore. -Cilësia e ujit është shumë e mirë.

Bulgarec: Rr. "Meras", sistemimin dhe pastrimin e kanaleve që kalojnë para hyrjeve të 25 banesave.

Lagjja "Ish SMT", zgjidhja e problematikave në lidhje me kanalizimet e ujrave të zeza.

KANALET KULLUESE/VADITËSE

Përfaqësuesit e komunitetit të përfshirë në forumet publike nxorën në pah që situata në fshatra të ndryshme nuk është e njëjtë. Në njësinë Qendër Bulgarec cilësia e kanaleve kulluese është shumë e mirë. Bashkia ka bërë një punë shumë të mirë në lidhje

me menaxhimin e kanaleve kulluese/vaditëse dhe çdo fshatar ka mundësi vaditjeje. Gjithsesi, ngelen akoma disa probleme që duhen parë nga bashkia me prioritet për tu zgjidhur.

Për shembull, në fshatin Mborje nuk ka kanale vaditëse, ndonëse ka 2 vjet që paguhen taksat. Kjo ka sjellë që tokat të mbeten djerrë për shkak të mungesës së ujitjes. Në fshatin Mollaj kur vjen koha për vaditje, për shkak të një menaxhimi jo të mirë (hartimit të një grafiku ku të gjithëve t'u jepet mundësi), jo të gjitha tokat arrijnë të vaditen dhe banorët detyrohen ta blejnë ujin me bot.

Prioritet 9. Adresimi me prioritet për krijimin e kanaleve vaditëse atje ku mungojnë dhe përmirësimi i mekanizmave menaxhuese për t'u dhënë mundësi të barabarta të gjithë banorëve për shfrytëzimin e burimeve të brendshme ekzistuese.

Mborje: Krijimi i kanaleve vaditëse.

Mollaj: Përdorimi i një grafiku, nëpërmjet të cilit t'u jepen mundësi të barabarta të gjithëve për vaditje.

KOPSHTET DHE ÇERDHET

Pavarësisht faktit që Bashkia Korçë e ka pasur në vëmendje shtimin e numrit të çerdheve në qytetin e Korçës, përsëri ky ngelet një nga prioritetet e qytetarëve që kërkon zgjidhje. Ekzistojnë vetëm 2 çerdhe publike dhe të tjerat janë private, ndërkohë që jo të gjithë kanë mundësi t'i çojnë fëmijët e tyre në çerdhe private. Gjithashtu vlen për tu përmendur që kapaciteti i tyre është shumë i ulët.

Prioritet 10. Të shtohet numri i çerdheve në qytetin e Korçës.

TRANSPORTI PUBLIK

Në të gjitha forumet u theksua se transporti është i zgjidhur, pjesërisht nëpërmjet atij publik dhe nga ai privat kur nuk plotësohet kriteri i distancës prej 5 Km nga qyteti i Korçës.

Një shqetësim për banorët e fshatrave është që nxënësit nga fshati, të cilët frekuentojnë shkollat e mesme të qytetit Korçë, shpesh vonohen për të arritur në shkollë. Kjo sepse me vendosjen e stacionit të furgonave tek terminali i ri i qytetit, është rritur distanca. Për këtë arsye, pjesëmarrësit në forume kërkuar rivlerësimin e orareve të nisjes së furgonave në mëngjes.

SHËRBIMET PUBLIKE

Prioritet 11. Rivlerësimi i orareve të mëngjesit për transportin publik nga fshatrat për në qytetin e Korçës.

SHËRBIMI VETERINAR

Pjesëmarrësit në forume vlerësuan si prioritet shërbimin veterinar.

Në fshatin Mollaj ky shërbim ofrohet vetëm privatisht, ndërkohë që në fshatrat Bulgarec dhe Mborje ofrohen vaksinat falas. Ata kërkuar gjithashtu paisjen me dokument për vaksinat.

Prioritet 12. Ofrimi i shërbimit veterinar falas në të gjitha zonat ku mungon dhe paisja me dokument në lidhje me vaksinat.

NIVELI I TAKSAVE/TARIFAVE NË RAPORT ME SHËRBIMIN

Përfaqësues nga OJF-të theksuan se tarifat vendore janë tepër të larta për këtë kategori dhe tepër të larta krahasuar me bashkitë e tjera në vend.

Prioritet 13. Krijimi i lehtësive në nivelin e taksave/tarifave për kategoritë në nevojë dhe ulja e tyre për organizatat jofitimprurëse (OJF).

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Pavarësisht faktit që bashkia Korçë ka një plan strategjik, qytetarët nuk kishin informacion për këtë. Një nga problemet shumë të ndjeshme për qytetarët e Njësisë Administrative Qendër Korçë (qyteti Korçë) është ai i ndotjes së ambientit. Duke kërkuar kështu ndërhyrjen e duhur për ruajtjen e mjedisit nga ndotja e ajrit dhe ndotja akustike, por po ashtu dhe nga ndotja elektromagnetike, e cila është 300 fish mbi normën e lejuar.

Prioritet 14. Hartimi i plane-programeve konkrete me ndikim në komunitet për mbrojtjen e mjedisit; Investim të shtuar në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, si dhe monitorimin sa më të mirë të ndotjes së ajrit dhe ujit.

DIMENSIONI SOCIAL

PROGRAME DHE SHËRBIME TË BASHKISË MBI ADRESIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Shumica e pjesëmarrësve në forume, sidomos në zonat rurale, nuk kishin informacion mbi ekzistencën e programeve të Bashkisë për adresimin e dhunës në familje. Megjithatë, ata theksuan nevojën që çështjet e dhunës në familje të vijojnë të trajtohen me prioritet nga Bashkia, në mënyrë të veçantë për parandalimin dhe identifikimin e viktimave të dhunës në familje.

Prioritet 15. Shpërndarja e informacionit nga Bashkia tek qytetarët, mbi funksionimin e Mekanizmit Koordinues të Referimit.

Prioritet 16. Zgjerim i shërbimeve ekzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje.



SHËRBIMET PUBLIKE

PYJET DHE KULLOTAT

Në njësitë e Qendër Bulgarec, në fshatin Mollaj dhe Mborje diskutimin në lidhje me këtë çështje pjesëmarrësit e fokusuan më së shumti tek përdorimi i drurit për ngrohje. Shqetësimi i tyre ishte çmimi i drurit të zjarrit që vlerësohej i lartë.

DEMOKRACIA VENDORE

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Në të gjitha forumet u theksua se janë shumë të kënaqur me nivelin e informimit dhe komunikimit. Informacioni merret lehtësisht nëpërmjet zyrës së informimit.

Po ashtu u vunë në dukje edhe vështirësitë që kanë shumica e njerëzve për të marrë shërbime nga e-albania, sidomos personat e moshës së tretë, por jo vetëm. Ndërsa dokumentat që i nevojiten i marrin lehtësisht nga zyrat e shërbimit.

TRANSPARENCA NË VENDIMMARRJE

Bashkia përdor mjete të ndryshme për të bërë publik aktivitetin e saj, sidomos median informale Facebook, thënë kjo nga pjesëmarrësit. Vlerësimi i tyre për nivelin e transparencës së Bashkisë ishte shumë i mirë. Sipas tyre, ekzistojnë këndet për shfaqjen e njoftimeve por jo

të gjithë qytetarët janë në dijeni dhe informohen nëpërmjet këtyre këndeve.

Bashkia Korçë ka një faqe web-i. Nga diskutimi i përfaqësuesve nga shoqatat, duke iu referuar faktit që për vitin 2020 është bërë monitorimi i transparencës së Bashkisë rezultoi si më poshtë:

- Platforma · Programi i Transparencës · për Bashkinë Korçë, është e lehtë për t'u përdorur dhe e mirëstrukturuar;

Dokumentacioni që duhet të publikohet, përmban informacion të aksesueshëm për të gjithë qytetarët. Ai është lehtësisht i përdorshëm, pasi mund të shkarkohet dhe të printohet.

Gjithsesi duhet të vemë në dukje se, pas riorganizimit të kësaj platforme, nuk mundet të aksesohet nga faqja web e Bashkisë, duke vështirësuar kështu përpjekjet e qytetarëve që janë të interesuar për ta konsultuar.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

DIMENSIONI SOCIAL

PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Pavarësisht faktit që Bashkia Korçë ka një plan strategjik, qytetarët nuk kishin informacion për këtë. Vetëm pjesëmarrësit në forumin e fshatit Mborje ishin vënë në dijeni për planin e ujësjellësit në atë fshat.

Ndërkohë që doli në pah mungesa e njohjes nga qytetarët e programeve konkrete, me ndikim për zonën e tyre.

TAKIME PUBLIKE PËR BUXHETIN

Në të gjitha forumet u theksua se, takimet për buxhetin ishin të përvitshme dhe kjo praktikë duhet të vijojë të ndiqet nga Bashkia.

NJOFTIMI I QYTETARËVE MBI DETYRIMIN PËR TAKSAT/TARIFAT

Pjesëmarrësit e përfshirë në forume u shprehën se, marrin rregullisht njoftimet për taksat/tarifat dhe kjo praktikë duhet të vijojë të ndiqet nga Bashkia

PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMMARRJE

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të grave në Këshillin Bashkiak, megjithatë përfaqësimi i grave nga zonat e ish-komunave mbetet ende i ulët.

Prioritet mbeten programet ndërgjegjësuëse që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje, veçanërisht në zonat e Bulgarecit, Mborjes dhe Mollajt.

POP

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

